



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Komuna e Drenasit- Municipality of Drenas

Zyra e Kryetarit



REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLOGOC
GLOGOC MUNICIPALITY

11/07/ 2023			
Numër	Shitja	Vlera	
01	07001	33282	

Informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi funksionon duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr27/2012 MPB-03/2012 MAPL për Këshillat Komunal për Siguri në Bashkësi. Sipas këtij udhëzimi, neni 9 Detyrat dhe Përgjegjësitë e kryesuesi të KKSB-së, pika 1.8 është e obliguar të bëhet informimi i Kuvendit Komunal për aktivitetet e KKSB-së. Duke u bazuar në këtë udhëzim, ju informojm se në fillim të vitit 2023 me qëllim të realizimit të detyrave operative lidhur me çështjet e Sigurisë në Bashkësi, në mbështetje të nenit 7 të Ligjit nr.04/01-076, për Policinë, nenit 11, pika 2 e udhëzimit administrative nr.27/2012 MPB-03/2012 MAPL, për KKSB-në, është caktuar orari i punës, ku janë paraparë gjashtë (6) takime të rregullta të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, plan ky i cili është miratuar në fillim të vitit fiskal në mbledhjen e Kuvendit Komunal.

Në periudhën Janar-Qershor janë mbajtur 3 takime të rregullta, përkatësisht me datë 01 Shkurt, 23 Mars, 18 Maj 2023. Në këto takime janë diskutuar çështje të cilat lidhen me sigurinë në bashkësi në Komunën e Drenasit, si siguria e ambientit, siguria shëndetësore, siguria rrugore dhe propozime të tjera, të cilat janë adresuar pastaj edhe në mbledhjet e ekzekutivit. Ndërsa, janë mbajtur edhe tri mbledhje të Këshillit Lokal për Siguri Publike, ku janë trajtuar tema që ndërlidhen me sigurinë publike në komunën e Drenasit.

Në mbledhje janë ftuar anëtarët e KKSB-së dhe monitorues sipas afateve ligjore, përkatësisht 7 ditë para mbajtjes së takimit është dërguar ftesa bashkë me pikat e rendit të ditës, si dhe është publikuar në ueb faqen e komunës së Drenasit. Në mbledhjen e parë të mbajtur me 01 Shkurt janë diskutuar këto pika:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 19.12.2023:*
<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/01/Procesverbali-i-kksb-dhe-fiesa-e-dates-19-dhjetor.pdf>
2. *Plani i Punës së KKSB-së për vitin 2023;*
3. *Orari i mbajtjes së mbledhjeve të KKSB-së gjatë vitit 2023;*
4. *Raport lidhur me punën e KKSB-së gjatë vitit 2022;*
5. *Raport lidhur me gjendjen në komunën e Drenasit pas vërshimeve;*
6. *Projekti “Integra” apo “Nxitja e riintegritetit të qëndrueshëm lokal të grave dhe të rinjve të kthyer dhe njerëzve të cënueshëm lokalë në Kosovë”;*
7. *Të ndryshme*

Në këtë mbledhje është miratuar plani dhe orari i mbledhjeve. Ndërsa, në tri pikat e tjera anëtarët kanë raportuar para anëtarëve të KKSB-së, ku edhe janë përgjigjur në pyetjet e adresuara.

Mbledhja e dytë është mbajtur me datë 23 mars ku janë diskutuar temat si në vijim:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 01.02.2023:*
<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/02/Procesverbali-i-KKSB-se.pdf>
2. *Siguria në shkolla;*
3. *Të ndryshme*

Në këtë mbledhje është diskutuar çështja e sigurisë në shkolla, dhe me masat që duhet të ndërmerren për parandalim e dukurive negative dhe aktivizimin e të rinjve me aktivitete të cilat i distancojnë nga këto dukuri. Gjithashtu, tema të ndryshme që ndërlidhen me sigurinë. Ndërsa, mbledhja e tretë është mbajtur me datë 18 maj, ku janë diskutuar gjashtë (3) pika si:

1. *Procesverbali i mbledhjes së rregullt të KKSB-së të mbajtur me datë 23.03.2023:*
<https://kk.rks-gov.net/glllogoc/wp-content/uploads/sites/10/2023/04/Procesverbali-takimit-te-kksb-se.pdf>
2. *Raport për adresimin e kërkesave të komunës në Departamentin e Infrastrukturës Rrugore në Prishtinë lidhur me sanimin e gropave nëpër rrugë regionale.*

3. *Dukuritë negative të adoleshentët dhe veprimet në parandalimin e tyre.*

4. *Të ndryshme*

Edhe në këtë mbledhje janë diskutuar pikat sipas rendit të ditës dhe anëtarët e KKSB-së kanë diskutuar dhe paraqitur kërkesat e tyre lidhur me këto pika.

Për tri mbledhjet janë hartuar edhe procesverbale të cilat në përputhje me Udhëzimin Administrativ janë dërguar tek anëtarët dhe në Divizionin e MPB-së për Siguri në Bashkësi. Të njëjtat janë publikuar në ueb faqen zyrtare të komunës brenda afatit ligjor.

Sa i përket Këshillit Lokal për Siguri Publike (KLSP) gjatë kësaj periudhe ka mbajtur tri mbledhje ku janë trajtuar tema që ndërlidhen me Sigurinë Publike në komunën e Drenasit.



Kryetari i komunës

Ramiz Lladrovci